

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 20.06.2026

1. Pasqyrat e mëposhtme financiare paraprake lidhen me Magnezi sh.a, Karboni sh.a dhe Litiumi sh.a, të gjitha kompani publike me përgjegjësi të kufizuar (sh.a.).

Pasqyrat e pozitës financiare me datë 31 dhjetor 2025 janë si në vijim:

Litiumi	Magnezi	Karboni	
	€m	€m	€m
Pasuritë:			
Pasuritë jo-qarkulluese:			
Prona, fabrika dhe pasijet	620.0	500.0	500.0
Pasuritë biologjike	100.0	50.0	150.0
Investimet në pasuri të patundshme	300.0	200.0	100.0
Investimet në filiale:			
Karboni sh.a	625.0	-	-
Litiumi sh.a	155.0	635.0	-
Pasuritë financiare	<u>160.0</u>	<u>10.5</u>	<u>70.5</u>
	1,960.0	1,395.5	820.5
Pasuritë qarkulluese	<u>447.5</u>	<u>340.5</u>	<u>75.0</u>
Total pasuritë	2,407.5	1,736.0	895.5
Ekuiteti dhe detyrimet:			
Ekuiteti:			
Aksionet e zakonshme €1	675.0	605.0	400.0
Aksione të preferuara të papagueshme prej €2 secila	200.0	-	-
Fitimet e mbajtura	620.0	465.0	175.0
Komponentë të tjerë të ekuitetit	<u>62.5</u>	<u>40.0</u>	<u>47.5</u>
Total ekuiteti	1,557.5	1,110.0	622.5
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata	492.5	382.5	75.0
Detyrimet afatshkurtëra	<u>357.5</u>	<u>243.5</u>	<u>198.0</u>
Total detyrimet	<u>850.0</u>	<u>626.0</u>	<u>273.0</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	2,407.5	1,736.0	895.5

Informata shtesë:

- i) Detyrimet afatshkurtra të Magnezi përfshijnë €144 milionë që u detyrohen furnitorëve të saj të huaj nga shtetet tjera. Kjo shumë nuk është përditësuar ende me humbjen përkatëse nga kursi i këmbimit prej €100 milionë.
- ii) Më 1 janar 2024, Magnezi sh.a bleu 14% të interesit të ekuitetit të Litiumi sh.a për një pagesë në para prej €130 milionë, dhe Karboni sh.a bleu 70% të interesit të ekuitetit të Litiumi sh.a për një pagesë në para prej €635 milionë. Më 1 janar 2024, pasuritë neto të identifikueshme të Litiumi sh.a kishin një vlerë të drejtë prej €495 milionë, fitimet e mbajtura ishin €95 milionë dhe komponentët e tjerë të ekuitetit ishin €26 milionë.

iii) Informacioni i mëposhtëm lidhet me planin e pensionit të grupit të Magnezi sh.a:

	1 janar 2025	31 dhjetor 2025
	€m	€m
Vlera e drejtë e pasurive të planit	16	16.5
Vlera aktuale e detyrimit të përfitimit të përcaktuar	17	19.5

Kontributet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 të pranuar nga fondi ishin €1 milion dhe përfitimet e punonjësve të paguara gjatë vitit arritën në €1.5 milion. Norma e skontimit që do të përdoret në çdo llogaritje është 5%. Kostoja e shërbimit aktual për periudhën bazuar në llogaritjet aktuariale (vleresimet e ekspertit) është €0.5 milion. Shifrat e mësipërme nuk janë kontabilizuar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, me përjashtim të kontributeve të paguara të cilat janë paguar në para dhe detyrimin e përfitimit të përcaktuar.

- iv) Më 1 janar 2025, Magnezi sh.a bleu 60% të interesave të ekuitetit të Karboni sh.a, një kompani publike me përgjegjësi të kufizuar. Kostoja e investimit përbëhej nga paraja prej €625 milionë. Më 1 janar 2025, vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të blera ishte €975 milionë, fitimet e mbajtura të Karboni sh.a ishin €325 milionë dhe komponentët e tjerë të ekuitetit ishin €27.5 milionë. Teprica në vlerën e drejtë vjen nga toka e jo-zhvlërësueshme. Është politikë e grupit që të masë interesin jo-kontrollues (IJK) në blerje sipas pjesës proporcionale të vlerës së drejtë të pasurive neto të filialit në momentin e blerjes.
- v) Më 1 janar 2025, pasuritë neto të identifikueshme të Litiumi sh.a kishin një vlerë të drejtë prej €575 milionë, fitimet e mbajtura ishin €120 milionë dhe komponentët e tjerë të ekuitetit ishin €35 milionë. Teprica në vlerën e drejtë vjen nga toka e jo-zhvlërësueshme. Vlera e drejtë e zotërimit prej 14% të Magnezi sh.a në Litiumi sh.a, i cili ishte klasifikuar si vlerë e drejtë përmes fitimit ose humbjes, ishte €140 milionë më 31 dhjetor 2024 dhe €155 milionë më 31 dhjetor 2025. Sidoqoftë, vlera e drejtë e interesit të Karboni sh.a në Litiumi sh.a nuk kishte ndryshuar që nga blerja.
- vi) Zëri i mirë i Karboni sh.a dhe Litiumi sh.a u testuan për dëmtim më 31 dhjetor 2025 dhe u zbulua se nuk kishte dëmtim lidhur me Litiumi sh.a. Sidoqoftë, zëri i mirë i Karboni sh.a ishte plotësisht i dëmtuar deri në datën e raportimit.
- vii) Më 1 janar 2024, Magnezi sh.a bleu një ambient për zyra me një kosto prej €90 milionë me një jetëgjatësi të dobishme të vlerësuar prej 30 vitesh. Gjatë vitit, tregu i pronave në zonë pësoi rënie dhe vlera e drejtë e ambientit ra në €75 milionë më 31 dhjetor 2024 dhe kjo u pasqyrua në pasqyrat financiare. Sidoqoftë, tregu u rimëkëmb papritur dhe shpejt për shkak të shpalljes së një investimi të madh qeveritar në infrastrukturën e transportit të zonës.

Më 31 dhjetor 2025, vlerësuesi njoftoi Magnezi sh.a se zyrat tani duhet të vlerësohen në €105 milionë. Magnezi sh.a ka llogaritur zhvlërësimin për vitin, por nuk ka marrë

parasysh rritjen e vlerësimit të zyrave. Magnezi sh.a përdor modelin e rivlerësimit dhe regjistron çdo ndryshim vlerësimi kur këshillohet ta bëjë këtë.

- viii) Magnezi sh.a ka shpallur dy plane të mëdha ristrukturimi gjatë vitit. Plani i parë është të reduktojë kapacitetin e saj përmes mbylljes së disave prej fabrikave të saj më të vogla, të cilat tashmë janë identifikuar. Kjo do të çojë në largimin nga puna të 144 punonjësve, të cilët janë përzgjedhur të gjithë individualisht dhe u është komunikuar vendimi. Kostot e këtij plani janë €10 milionë kosto largimi nga puna, €5 milionë kosto ritrajnimi dhe €4 milionë kosto për ndërprerjen e qirasë. Plani i dytë është riorganizimi i departamentit të financës dhe teknologjisë së informacionit gjatë një periudhe një (1) vjeçare, por ai nuk fillon para dy viteve. Plani do të rezultojë që 15% e stafit të financës të humbasin vendet e punës gjatë ristrukturimit. Kostot e këtij plani janë €10 milionë kosto largimi nga puna, €6 milionë kosto ritrajnimi dhe €7 milionë kosto për ndërprerjen e qirasë së pajisjeve. Nuk është bërë asnjë regjistrim në pasqyrat financiare për planet e mësipërme.

Kërkohet:

Përgatitni pasqyren e konsoliduar të pozitës financiare të grupit të Magnezi sh.a me datë 31 dhjetor 2025.

(30 pikë)

1. Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare të Grupit Magnezi me datë 31 dhjetor 2025

Pasuritë:	€'milion
Pasuritë jo-qarkulluese:	
Prona, fabrika dhe pasijet (620 + 500 + 500 + 17.5 + 20 + 32.60)	1,690.10
Pasuritë biologjike (100 + 50 + 150)	300.00
Investimet në pasuri të patundshme (300 + 200 + 100)	600.00
Zëri i mirë (L13)	199.00
Pasuritë financiare (160 + 10.5 + 70.5)	<u>241.00</u>
Totali i pasurive afatgjata	3,030.10
Aktivët afatshkurtra (447.5 + 340.5 + 75)	<u>863.00</u>
TOTALI I PASURIVE	3,893.10
Ekuiteti dhe detyrimet	
Aksionet e zakonshme	675.00
Aksione të preferuara të papagueshme €2	200.00
Fitimet e mbajtura (L15)	576.85
Komponentët e tjerë të ekuitetit (L16)	<u>95.55</u>
Totali i ekuitetit që u takon aksionarëve të prindit	1,547.40
Interesi jo-kontrollues (IJK) (L14)	<u>479.70</u>
Totali i ekuitetit	2,027.10
Totali i detyrimeve afatgjata (492.5 + 382.5 + 75 + 3)	953.00
Detyrimet afatshkurtra (357.5 + 243.5 + 198 + 14 + 100)	<u>913.00</u>
Totali i detyrimeve	<u>1,766.00</u>
TOTALI I EKUITETIT DHE DETYRIMEVE	3,893.10

Llogaritjet:

(1) Struktura e Grupit

Interesi efektiv i grupit në Litiumi sh.a është:

- Interesi direkt: 14%
- Interesi indirekt ose interesi efektiv: $(60\% \times 70\%) = \underline{42\%}$
- **Interesi efektiv i Grupit:** 56%
- Interesi i IJK në Litiumi sh.a është pra: $(100\% - 56\%) = \underline{44\%}$

Konsolidimi i Karboni sh.a:

- Grupi: 60%
- IJK: $(100\% - 60\%) = 40\%$

Shënim: Data e blerjes për Litiumi sha është 1 janar 2025, pasi kjo është koha kur Magnezi sh.a mori kontrollin mbi Karboni sh.a dhe rrjedhimisht kontrollin indirekt mbi Litiumi sh.a.

(2) Pasuritë neto

Karboni	Data e blerjes	Data e raportimit	Pas blerjes
	€'m	€'m	€'m
Aksionet e zakonshme	605	605	-
Komponentët e tjerë	27.5	40	12.5
Fitimet e mbajtura	325	465	140
Rregullimi i vlerës së drejtë - Toka (shifër balancuese)	<u>17.5</u>	<u>17.5</u>	<u>-</u>
	975	1,127.5	152.5
Litiumi			
Aksionet e zakonshme	400	400	-
Komponentët e tjerë	35	47.5	12.5
Fitimet e mbajtura	120	175	55
Rregullimi i vlerës së drejtë - Toka (shifër balancuese)	<u>20</u>	<u>20</u>	<u>-</u>
	575	642.5	67.5

Prandaj, fitimet pas blerjes së Karboni sh.a janë €152.5 milionë (€1,127.5 - €975) dhe ato të Litiumi sh.a janë €67.5 milionë (€642.5 - €575).

(3) Zëri i mirë

Kostoja e Litiumis ka tre elemente: kostoja e mbajtjes direkte, kostoja e mbajtjes indirekte dhe rregullimet e mbajtjes indirekte

Karboni	€'milion
Vlera e drejtë e pagesës:	625
IJK në blerje (40% x €975)	390
Vlera e drejtë e pasurive neto të blera (L12)	<u>(975)</u>
Zëri i mirë në blerje:	40
Humbja nga dëmtimi	<u>(40)</u>
Zëri i mirë në datën e raportimit	0

Investimi i Magnezi sh.a në Litiumi sh.a mbahej në vlerën €155 milionë në datën e raportimit. Prandaj, rritja e vlerës së drejtë prej €15 milionë (€155 milionë - €140 milionë) që ka lindur që nga data kur u arrit kontrolli duhet të hiqet nga pasqyrat financiare të konsoliduara. Fitimet e mbajtura gjithashtu duhet të reduktohen me €15 milionë.

Litiumi	€'milion
Vlera e drejtë e pagesës së blerjes:	
- Zotërimi direkt:	140
- Zotërimi indirekt (60% x 635):	381
IJK në blerje (44% x €575)	253
Minus vlera e drejtë e pasurive neto (LL2)	<u>(575)</u>
Zëri i mirë në datën e raportimit	199

(4) Interesi jo-kontrollues (IJK)

	€'milion
Mënyra e parë	
IJK në Karboni në blerje (40% x €975)	390
Pjesa e pasurive neto pas blerjes të Karboni (40% x (€1,127.5m - €975m))	61
Kostoja e investimit në Karboni që i takon IJK (40% x €635m) (254)	
IJK në Litiumi në datën e blerjes (€575m x 44%)	253
Pjesa e pasurive neto pas blerjes të Litiumi (44% x (€642.5 - €575))	<u>29.7</u>
Totali IJK	479.7

Metoda Alternative	€'milion
IJK në pasuritë neto të Karboni në datën e raportimit (40% x €1,127.5)	451
IJK në pasuritë neto të Litiumi në datën e raportimit (44% x €642.5)	282.7
Pjesa e IJK-dë në investimin në Karboni (40% x €635)	<u>(254)</u>
Totali IJK	479.7

(5) Fitimet e mbajtura	€'milion
Magnezi	620
Humbja nga kursi i këmbimit	(100)
Pjesa e fitimeve pas blerjes	
Karboni: 60% x (€152.5m - €12.5m) (LL2)	84
Litiumi: 56% x (€67.5m - 12.5m)(L12)	
30.8	
Fitimi nga investimi në Litiumi (L13)	(15)
Dëmtimi i zërit të mirë (L13)	(40)
Anulimi i humbjes nga dëmtimi (L16)	11.60
Provizioni për ristrukturim (L17)	(14)
Shpenzimet e planit të pensionit (L18)	<u>(0.55)</u>
Totali	576.85

(6) Komponentët e tjerë të ekuitetit	€'milion
Magnezi	62.5
Karboni (60% x (€40 million – €27.5 million) (L12))	7.5
Litiumi (56% (€47.5 million – €35 million) (L12))	7
Fitimi nga rivlerësimi (L16)	21.00
Humbja nga rivlerësimi i planit të pensionit (L18)	<u>(2.45)</u>
Totali	95.55

(7) Ambientet e zyrave	€'milion
Kostoja:	90
Zhvlerësimi (90/30 vite)	<u>(3)</u>
Vlera kontabël:	87
Humbja nga rivlerësimi F ose H	<u>(12)</u>
Vlera e drejtë më 31 dhjetor 2024:	75
Zhvlerësimi (75/29 vite)	<u>(2.6)</u>
	72.4
Teprica e rivlerësimit (TTGJ):	<u>32.60</u>
Vlera e drejtë më 31 dhjetor 2025:	105.0

Shpjegim: Më 31 dhjetor 2024, prona pësoi një humbje nga dëmtimi prej €12 milionë e cila u ngarkua në fitim ose humbje. Më 31 dhjetor 2025, prona u rrit në vlerë në €105 million. Anulimi i dëmtimit është i kufizuar në vlerën kontabël që prona do të kishte pa dëmtim (€84 milionë). Teprica e fitimit duhet të kontabilizohet si fitim nga rivlerësimi në përputhje me SNK 16.

Nëse nuk do të kishte ndodhur asnjë dëmtim, prona do të mbahej në vlerën €84 milionë (€90 milionë – (2 x €3 milionë)). Prandaj, fitimi i regjistruar në fitim ose humbje është €11.6 milionë (€84 milionë – €72.40 milionë). Pjesa tjetër e fitimit njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse si një fitim nga rivlerësimi. d.m.th.? €105 milionë – €84 milionë = €21 milionë.

Regjistrimet

Debi	Toka, ndërtesa dhe pajisje	€32.60 milionë
Kredi	Fitim ose Humbje	€11.60 milionë
Kredi	TTGJ	€21.00 milionë

8) Provizionit për ristrukturim

SNK 37 kërkon që vetëm ato kosto që rrjedhin drejtpërdrejt nga dhe janë domosdoshmërisht të përfshira nga një ristrukturim mund të përfshihen në një provizion ristrukturimi. Kjo përfshin kosto të tilla si kostot e shkurtimit të vendeve të punës të punonjësve ose kostot e përfundimit të qirasë. Shpenzimet që lidhen me aktivitete të vazhdueshme, të tilla si zhvendosja dhe ritrajnimi, përjashtohen. Një provizion ristrukturimi duhet të njihet vetëm nëse punonjësit e prekur janë identifikuar dhe janë komunikuar, dhe nëse kostot mund të maten me besueshmëri.

Lidhur me reduktimin e shërbimit, duhet të njihet një provizion për kostot e shkurtimit të personelit dhe përfundimit të qirasë prej €14 milionë (€10 milionë + €4 milionë). Vendndodhjet dhe detajet e kostove të shkurtimit të personelit janë identifikuar.

Magnezi sh.a nuk duhet të njohë një provizion për riorganizimin e departamentit të financave dhe TI-së. Riorganizimi nuk pritet të fillojë për dy vjet. Palët e interesit jashtë nuk ka gjasa të kenë një pritje të vlefshme se menaxhmenti është i angazhuar për riorganizimin, pasi afati kohor i jep mundësi të konsiderueshme menaxhmentit për të ndryshuar detajet e planit ose edhe për të vendosur të mos vazhdojë me të. Përveç kësaj, shkalla e identifikimit të stafit që do të humbasin vendet e tyre të punës nuk është mjaftueshëm e detajuar për të mbështetur njohjen e një provizioni për shkurtimin e vendeve të punës.

Regjistrimet:

Debi	Fitimet e mbajtura	€14 milionë	
Kredi	Detyrimet afatshkurtra		€14 milionë

(9) Plani i pensionit

Për të llogaritur përbërësin e rimatjes, duhet të rikonsiloni deficitin neto të pensioneve në fillim dhe në fund. Përbërësi i rimatjes llogaritet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Detyrimi i njohur në pasqyrat financiare do të jetë €3 milionë (domethënë, €17.5 milionë - €14.5 milionë)	€ milionë
Detyrimi neto më 1 janar 2025 (€17 milionë - €16 milion)	1.0
Përbërësi neto i interesit (€1 milionë x 5%)	0.05
Kontributet	(1)
Përbërësi i kostos së shërbimit	<u>0.5</u>
Detyrimi i pritur	0.55
Humbja nga rimatja (shifra e mbetur)	<u>2.45</u>
Detyrimi neto më 31 dhjetor 2025 (19.5 -16.5)	3

Përbërësi i kostos së shërbimit dhe përbërësi neto i interesit do të ngarkohen në fitim ose humbje (€0.55 milionë) dhe humbja nga rimatja në të Ardhurat e Tjera Gjithëpërfshirëse (€2.45 milionë). Nuk do të ketë rregullim për kontributet, të cilat janë marrë tashmë në konsideratë.

2. Kalcium sh.a lidh një kontratë më 1 janar 2025 për të ndërtuar një makinë shtypi në ambientet e një klienti për një shpërblim të premtuar prej €3,000,000 me një bonus prej €200,000 nëse makina përfundon brenda 24 muajve. Në fillim të kontratës, Kalcium sh.a e llogarit saktë paketën e premtuar të mallrave dhe shërbimeve si një detyrim të vetëm performance në përputhje me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me konsumatorët*.

Në fillim të kontratës, Kalcium sh.a pret që kostot të jenë €1,600,000 dhe arrin në përfundimin se është shumë e mundshme që të ndodhë një anulim i konsiderueshëm në shumën e të ardhurave kumulative të njohura pasi që bonusi nuk mund të arrihet. Përfundimi i makinës së shtypit është shumë i ndjeshëm ndaj faktorëve jashtë ndikimit të Kalcium sh.a, kryesisht çështjeve me furnizimin e komponentëve. Më 31 dhjetor 2025, Kalcium sh.a ka përbushur 65% të detyrimit të saj të performancës në bazë të kostove të bëra deri më sot dhe arrin në përfundimin se shumica e konsideratës variable është ende e kufizuar (paarritshme) në përputhje me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me konsumatorët*.

Megjithatë, më 4 janar 2026, kontrata modifikohet me rezultatin që shumica fikse dhe kostot e pritura rriten përkatësisht me €220,000 dhe €120,000. Koha e lejuar për arritjen e bonusit zgjatet me gjashtë muaj me rezultatin që Kalcium sh.a arrin në përfundimin se është shumë e mundshme që bonusi të arrihet dhe se kontrata mbetet ende një detyrim i vetëm i performancës. Kalcium sh.a ka një vit kontabël që përfundon më 31 dhjetor.

Kërkohe:

Diskutoni se si duhet të kontabilizohet kontrata e mësipërme sipas SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me konsumatorët*, deri më 4 janar 2026. (10 pikë)

2.

Kalcium sh.a e llogarit paketën e premtuar të mallrave dhe shërbimeve si një detyrim të vetëm performance të përmbushur me kalimin e kohës në përputhje me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me konsumatorët*. Në fillim të kontratës, Kalcium sh.a pret sa vijon:

Çmimi i transaksionit	€3,000,000
Kostot e pritura	<u>€1,600,000</u>
Fitimi i pritur (46.7%)	€1,400,000

Në fillim të kontratës, Kalcium sh.a përjashton bonusin prej €200,000 nga çmimi i transaksionit sepse nuk mund të arrijë në përfundimin se është shumë e mundshme që kjo do të arrihet. Përfundimi i makinës së shtypjes është shumë i ndjeshëm ndaj faktorëve jashtë ndikimit të njësisë. Deri në fund të vitit të parë, kompania ka përmbushur 65% të detyrimit të saj të performancës në bazë të kostove të bëra deri më sot. Kostot e bëra deri më sot janë pra €1,040,000 dhe Kalcium sh.a rivlerëson konsideratën e ndryshueshme dhe arrin në përfundimin se shuma është ende e kufizuar. Prandaj, më 31 dhjetor 2025, do të njiheshin sa vijon:

Të ardhura	€1,950,000
Kostot	<u>€1,040,000</u>
fitimi bruto	€910,000

Megjithatë, më 4 janar 2026, kontrata u modifikua. Si rezultat, shuma fikse dhe kostot e pritura rriten përkatësisht me €220,000 dhe €120,000. Shuma totale e mundshme pas modifikimit është €3,420,000, që është €3,220,000 shumë fikse + €200,000 bonus përfundimi. Përveç kësaj, koha e lejuar për arritjen e bonusit zgjatet me gjashtë muaj, me rezultatin që Kalcium sh.a arrin në përfundimin se është shumë e mundshme që përfshirja e bonusit në çmimin e transaksionit të mos rezultojë në një përmbysje të konsiderueshme në shumën e të ardhurave kumulative të njohura në përputhje me SNRF 15. Prandaj, bonusi prej €200,000 mund të përfshihet në çmimin e transaksionit. Kalcium sh.a gjithashtu arrin në përfundimin se kontrata mbetet një detyrim i vetëm performance. Kështu, Kalcium sh.a e llogarit modifikimin e kontratës sikur të ishte pjesë e kontratës origjinale. Prandaj, Kalcium sh.a përditëson vlerësimet e saj të kostove dhe të ardhurave si më poshtë:

Kalcium sh.a ka përmbushur 60.5% të detyrimit të saj të performancës (€1,040,000 kosto aktuale të bëra krahasuar me €1,720,000 kosto totale të pritura). Kompania njih të ardhura shtesë prej €119,100 [(60.5% e €3,420,000) - €1,950,000 të ardhura të njohura deri më sot] në datën e modifikimit si një rregullim kumulativ për të kapur ritmin. Meqenëse ndryshimi i kontratës ndodhi pas fundit të vitit, të ardhurat shtesë nuk do të trajtoheshin si një ngjarje rregulluese.

3.

(a)

(i) Diskutoni parimet e përgjithshme të njohjes për provizionet në përputhje me SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontinente dhe pasurië kontinente në lidhje me kontabilitetin e provizioneve.* (5 pikë)

(ii) Titani sh.a është një entitet i madh në sektorin e shitjes me pakicë në Kosovë dhe u formua më 28 nëntor 2012. Auditimi për vitin 2025 për Titani sh.a nuk ka filluar ende. Tarifa e vlerësuar e auditimit për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2025 është €30,000. Drejtorët i propozuan menaxherit të financave që ta llogarisin tarifën e auditimit në pasqyrat financiare të vitit 2025. Menaxheri i financave nuk ishte i sigurt nëse kjo tarifë duhej të parashikohej apo jo në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Kërkohet:

Diskutoni dse sa jeni dakord me trajtimin kontabël të propozuar nga drejtorët për tarifën e auditimit. (5 pikë)

(b) Neoni sh.a ka një degë jashtë vendit e cila ka pasur një humbje (të rregulluar për qëllime tatimore dhe të përkthyer në mënyrë të përshtatshme në Euro) prej €3,000 milionë për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025. Legjislacioni vendor i tatimeve lejon që kjo humbje të anulohet për qëllime tatimore vetëm kundrejt fitimeve të ardhshme në të njëjtin treg. Neoni sh.a nuk ka degë të tjera në të njëjtin juridiksion tatimor si kjo degë. Humbja është kryesisht për shkak të një uljeje të të ardhurave të shkaktuar nga një ulje e kërkesës për produktin që prodhon dega. Ka pak tregues se kërkesa do të rikthehet në nivelet e saj të mëparshme në të ardhmen e parashikueshme. Neoni sh.a ka njohur një pasuri tatimore të shtyrë prej €1,200 milionë në draft pasqyrat financiare, që janë pasojat e ardhshme tatimore të diferencës së përkohshme prej €3,000 milionë, të matura me normën lokale të tatimit prej 40%.

Kërkohet:

(i) Shpjegoni pse diferenca e përhershme midis fitimeve kontabël dhe fitimeve të tatueshme nuk ka pasojat tatimore të shtyra. (2 pikë)

(ii) Diskutoni vlefshmërinë e trajtimit kontabël të miratuar nga Neoni sh.a bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar përkatëse. Ju duhet të deklaroni qartë se çfarë rregullimi, nëse ka, është i nevojshëm në pasqyrat financiare të Neoni sh.a.

(3 pikë)

(c) Fosfori sh.a bleu një obligacion me interes 6% (i pagueshëm çdo vit në fund të vitit) prej €50 milionë (vlere nominale) më 1 janar 2025 me një zbritje prej 10% ndaj vlerës nominale. Shpenzimet e blerjes ishin €500,000. Obligacioni duhet të shlyhet më 31 dhjetor 2035 me vlerën nominale. Norma efektive vjetore e interesit deri në maturim është 7.3%. Fosfori sh.a synon ta mbajë obligacionin deri në datën e tij të maturimit.

Kërkohet:

Në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*, si duhet të njihet transaksioni i mësipërm në pasqyrat financiare të Fosfori sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025?

(5 pikë)

3.

(a)

(i) Sipas SNK / IAS 37, provizionet duhet të kontabilizohen [njihen] si detyrime në pasqyrat financiare në rastet kur:

- Entiteti ka një obligim aktual, qoftë ai ligjor ose i tërthortë
- Ka shumë mundësi [gjasa] që të nevojitet një transfer i përfitimeve ekonomike për të shlyer obligimin në fjalë
- Kur vlera monetare e obligimit mund të vlerësohet me besueshmëri

(ii)

Titani sh.a

Për: Drejtorët

Nga: Debit Krediti - Kontabilist Financiar

Data: 20 qershor 2026

Tema: Trajtimi kontabël i tarifës së vlerësuar të auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2025

1. Hyrje

Ky raport nxjerr në pah trajtimin e duhur kontabël të tarifës së vlerësuar të auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2025 që arrin në €30,000. Diskutimi dhe përfundimi bazohen kryesisht në:

- i) SNK 37 Provizionet, detyrimet kontingjente dhe asetet kontingjente
- ii) SNK 8 Politikat kontabël, vlerësimet dhe gabimet
- iii) SNK 10 Ngjarjet pas periudhës së raportimit

2. Njohja dhe matja

Një detyrim përcaktohet si një detyrim aktual i entitetit që rrjedh nga ngjarjet e kaluara. Detyrimet mund të jenë të zbatueshme ligjrisht për shkak të kërkesave ligjore. Një kompanie i kërkohet një auditim, pasi ka vepruar gjatë një viti financiar (ngjarjet e kaluara), kjo krijon një detyrim për të kryer një auditim. Prandaj, tarifat e auditimit duhet të llogariten nga një entitet që kërkohet me ligj të kryejë një auditim. Një gjë e rëndësishme për t'u theksuar është se çdo kompani si një entitet i regjistruar është e detyruar të auditojë financat e saj në fund të çdo viti financiar. Prandaj, nëse është e detyrueshme që një kompani të auditojë financat e saj (gjë që e bën atë të ligjshme), kjo do të thotë që duhet të paguhet një tarifë auditimi për atë vit, prandaj për të paraqitur pozicionin e kompanisë duhet të përlllogariten tarifat. SNK 37 krijon hapësirë për një vlerësim të arsyeshëm nëse shuma nuk dihet.

SNK 37 flet për një ngjarje detyruese dhe kjo duhet të jetë ose ligjore ose e tërthortë. Detyrimi i tërthortë është kur është krijuar një pritje e vlefshme. Nëse një kompani ka krijuar një pritje për auditimin e pasqyrave të saj çdo vit, atëherë është krijuar një ngjarje detyruese (pra një detyrim aktual) pavarësisht nëse kompania duhet me ligj të auditojë pasqyrat e saj. Një provizion duhet të njihet për atë auditim. Standardi e bën të qartë se një kompani duhet të rishikojë provizionin e saj periodikisht dhe nëse për ndonjë arsye provizionet nuk kërkohen më, atëherë ato duhet të anulohen.

Nga ana tjetër, asnjë provizion nuk duhet të njihet për asnjë punë që nuk është kryer ende në datën e raportimit. Arsyeja për këtë është se SNK 37 kërkon (ndër të tjera) që të ekzistojë një detyrim që ekziston tashmë në datën e raportimit, i cili ka lindur si rezultat i një ngjarjeje të kaluar. Deri në kohën kur kryhet puna e auditimit, nuk ka ngjarje të kaluar. Në fakt, është një kontratë ekzekutive e cila normalisht përjashtohet nga fushëveprimi i SNK 37. Për arsyet e mësipërme, është e papërshtatshme të njihet një dispozitë e tillë.

Megjithatë, në praktikë, dispozita të tilla ka të ngjarë të jenë të parëndësishme dhe për këtë arsye ndonjëherë kompanitë e njohin dispozitën në bazë të faktit se standardet nuk zbatohen për zërat e parëndësishëm. Prandaj, do të jetë çështje e një politike kontabël. Në këtë rast, tarifat e auditimit duhet të njihen çdo vit si shpenzim (kryesisht një zë më vete nën shpenzimet e administrimit ose si pjesë e shpenzimeve profesionale). Edhe kur nuk janë marrë vlerësimet e tarifave nga auditorët, një dispozitë bëhet në çdo kohë gjatë vitit financiar, pasi parashikimi për tarifat e auditimit ndjek parimin e kujdesit të kontabilitetit, si dhe konceptin aktual. Prandaj, nuk ka nevojë të prisni që auditorët të vijjnë dhe të auditojnë pasqyrat dhe faturuar tarifat. Është një shpenzim i përsëritur që duhet të kryhet nga çdo entitet, pra i njohur mbi këtë bazë. Vlerësimet kontabël shpesh përfshihen në pasqyrat financiare historike.

Të gjitha rregullat e kontabilitetit i nënshtrohen interpretimit dhe zbatimit bazuar në një situatë specifike. Konsideratat duhet të bazohen në madhësinë e kompanisë, praktikat dhe pragjet e materialitetit, si dhe tolerancën ndaj riskut. Nëse kompania juaj auditohet çdo vit dhe historikisht keni përlogaritur një shumë vjetore për tarifat e auditimit në baza mujore që pasqyrojnë nga afër koston aktuale siç është bërë, nuk ka asgjë të keqe të vazhdoni atë praktikë. Është më konservatorja.

Prandaj, tarifat e auditimit duhet të përlogariten në vitin 2025, pasi ka detyrime ligjore, shuma gjithashtu mund të matet/vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundshme që të ketë një rrjedhje të përfitimeve ekonomike në të ardhmen. Kompania duhet gjithashtu të marrë në konsideratë materialitetin dhe praktikën e kaluar.

Me respekt,



Debit Krediti

b)

(i)

SNK 12 *Tatimet në të ardhurat* e përkufizojnë tatimin e shtyrë si pasojat e ardhshme tatimore të parashikuara të transaksioneve dhe ngjarjeve të njohura në pasqyrat financiare të periudhave aktuale dhe të mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm nga një entitet për një periudhë kontabël varet nga fitimi i tatueshëm i entitetit për atë periudhë. Megjithatë, ky fitim i tatueshëm shpesh do të jetë i ndryshëm nga fitimi i paraqitur në pasqyrat financiare (fitimi kontabël). Disa nga të ardhurat e paraqitura në pasqyrat financiare mund të mos jenë të ngarkueshme për tatimin dhe në mënyrë të ngjashme, disa nga shpenzimet e paraqitura në pasqyrat financiare mund të mos jenë të zbritshme për qëllime tatimore. Diferencat e përhershme janë ndryshime të njëhershme midis fitimeve kontabël dhe të tatueshme të shkaktuara nga disa zëra që nuk janë të tatueshëm ose të zbritshëm, dhe për këtë arsye ndikojnë vetëm në llogaritjen e tatimit të një periudhe (periudha kur ndodh ngjarja ose transaksioni). Prandaj, ndryshimet e përhershme nuk kanë një pasojë tatimore të shtyrë.

(ii)

SNK 12 është i qartë mbi rrethanat në të cilat një pasuri e tatimit të shtyrë mund të njihet si rezultat i humbjeve tatimore të papërdorura. Një pasuri e tatimit të shtyrë duhet të njihet vetëm në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit humbjet tatimore të papërdorura mund të përdoren.

Në pyetje na thuhet se ka pak tregues se kërkesa do të rritet në të ardhmen e parashikueshme, kështu që nuk mund të themi se është e mundshme që fitimet e ardhshme të jenë të disponueshme. Asnjë pasuri e tatimit të shtyrë nuk duhet të njihet në lidhje me humbjen e tatueshme.

Rregullimi i nevojshëm në ditar do të jetë:

Debi	Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat në fitim ose humbje	€1,200 milionë
Kredi	Pasuritë jo-qarkulluese e tatimit të shtyrë <i>Shlyerja e pasurisë së tatimit të shtyrë të njohur gabimisht</i>	€1,200 milionë

(c)

Ky obligacion përmbush kriteret për klasifikimin e tij si Kosto e Amortizuar. Këto janë:

- rrjedhate parave që do të nxirren nga instrumenti janë vetëm interesi dhe kryegjësja, dhe
- entiteti synon ta mbajë instrumentin për të arkëtuar rrjedhat e parave kontraktuale.

Prandaj, metoda e kostos së amortizuar është e përshtatshme. Vlera e drejtë është e parëndësishme.

Vlera fillestare kontabël e obligacionit do të jetë si më poshtë:

	€
Çmimi i blerjes (90% of €50)	45
Shto: Kostot e transksionit	<u>0.5</u>
Total pasuria e njohur	45.5
Të hyrat financiare do të njihen me 7.3% në shumën bartese prej 45.5 =	<u>3.32</u>
Pasuria financiare në fund = 45.5+ 3.32-3 (kuponi i arkëtuar) =	45.82

4.

a) Oksigjeni sh.a është një kompani kosovare e teknologjisë financiare dhe tregtisë elektronike me seli në Mitrovicë. Që nga 1 janari 2023, Oksigjeni sh.a filloi zhvillimin e një softueri të brendshëm për prodhimin e hartave me rezolucion të lartë. Kostot e zhvillimit arritën në total €1.2 milion gjatë dy viteve të para. Kostoja për të përcaktuar kërkesat e projektit ishte €200,000 (e përfshirë në kostot totale prej €1.2 milion të përmendura tashmë). Sistemi u vu në shërbim më 1 janar 2025 dhe pritet të ketë një jetëgjatësi të dobishme prej 5 vitesh.

Një firmë konsulence e palës së tretë u angazhua për një tarifë prej €100,000 për të konsultuar dhe hartuar një emër të ri marke.

Kërkohet:

Në përputhje me SNK 38 Pasuritë e paprekshme tregoni trajtimin e duhur të raportimit financiar të transaksionit të mësipërm në pasqyrat financiare të Oksigjeni sh.a. (6 pikë)

b) Klori sh.a bleu tokë ku ndodhet një fabrikë në një kombinim biznesi. Toka aktualisht përdoret si punishte për fabrikë. Toka ndodhet në qendër të qytetit që është vlerësuar shumë, dhe një numër vendesh aty pranë janë zhvilluar për apartamente të larta banimi.

Vlera e drejtë e tokës si vend për fabrikë është €10 milionë. Vlera e drejtë e tokës dhe e fabrikës është €20 milionë. Nëse fabrika demolohet, do të ketë një kosto neto prej €2 milionë. Nuk është praktike të zhvendoset fabrika.

Vlera e drejtë e tokës nëse është e lirë për zhvillim banimi është €15 milionë, duke përjashtuar kostot e ri-zonimit. Nëse toka zhvillohet në apartamente, vlera e mbetur e tokës (vlera e tokës minus kostot e zhvillimit) është €25 milionë, dhe vlera e tokës nëse zbritet një marzh normal fitimi për një zhvillues është €17 milionë (duke përjashtuar kostot e ri-zonimit). Që toka të shndërrohet në tokë banimi, do të ketë tarifa ri-zonimi dhe ligjore prej €1 milion.

Kërkohet:

Në përputhje me SNRF 13 Matjet e vlerës së drejtë, tregoni se si do të përcaktohet vlera e drejtë e tokës dhe çdo çështje tjetër të identifikuar. (6 pikë)

c) Bakri sh.a zotëron dhe operon një sistem shpërndarjeje karburanti në Evropën Perëndimore. Për shkak të përdorimit të shtuar në vitet e kaluara, pjesë të sistemit mund të tregojnë dobësi të pazbuluara që përfundimisht mund të çojnë në rrjedhje që do të sjellin kosto riparimi si materiale ashtu edhe mjedisore. Rreziku është shqyrtuar nga inxhinierët e brendshëm dhe përfundimi i tyre është se dëmi në mjedis do të jetë i moderuar pasi do të dëmtojë popullatën lokale të Minkëve Evropian.

Minkët Evropian janë specie të rrezikuara në Evropën Perëndimore dhe do të ketë kosto prej €1,750,000 për rikthimin e tyre në mjedis.

Kërkohet:

Diskutoni trajtimin kontabël sipas SNK 37 Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente për detyrimin mjedisor. (4 pikë)

d) Iridiumi sh.a, një kompani prind, kishte 6 milionë aksione të zakonshme të paguara plotësisht me vlerë €1 të emetuara më 1 janar 2025. Më 1 prill 2025, kompania bëri një konsolidim të aksioneve ekzistuese të emetuara (domethënë një ndarje të kundërt të aksioneve) me vlerë nominale, në bazë 2 për 3. Nuk pati dividend të veçantë, riblerje të aksioneve ose dalje të tjera burimesh. Pasi përfundoi konsolidimin e aksioneve, u bë një emetim i ri aksionesh për 600,000 aksione përmes një oferte për shitje me çmimin e tregut prej €1.55 për aksion. Emetimi u bë më 1 shtator 2025 dhe të ardhurat duhej të paguheshin më 1 tetor 2025.

Pasqyra (e përmbledhur) e fitimit ose humbjes së kompanisë për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025, siç është publikuar, tregohet më poshtë:

	€'000
Të hyrat	15,740
Kostoja e shitjeve dhe shpenzimet	<u>(16,060)</u>
Humbja para interesit dhe tatimit	(320)
Kosto financiare	<u>(128)</u>
Humbja për vitin	(448)
Fitimi/(humbja) që i atribuohet:	
Pronarëve të kompanisë mëmë	(478)
Interesave jo-kontrolluese	<u>30</u>
	(448)

Iridiumi sh.a gjithashtu kishte në emetim (në qarkullim) gjatë gjithë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2025, €500,000 aksione preferenciale kumulative me vlerë 5% të ripagueshme.

Kërkohet:

Në përputhje me SNK 33 *Fitimet për aksion*, llogaritni fitimin e thjeshtë për aksion për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025. (4 pikë)

a) Pasuritë e paprekshme

Softuer i Zhvilluar Brenda për Hartat me Rezolucion të Lartë

SNK 38 përcakton një pasuri të paprekshme si një pasuri jo-monetare të identifikueshme pa substancë fizike.

Për të njohur një pasuri të paprekshme, pasuria duhet të jetë:

- E identifikueshme (ose e ndashëm ose që rrjedh nga të drejtat kontraktuale/ligjore)
- E kontrolluar nga entiteti
- Pritet të ofrojë përfitime ekonomike në të ardhmen
- Kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri

Pasuritë e Paprekshme të Gjeneruara Brenda:

SNK 38 bën dallimin midis fazave të hulumtimit dhe zhvillimit (H&Zh):

Kostot e bëra gjatë fazës së hulumtimit duhet të shpenzohen sapo të ndodhin.

Kostoja prej €200,000 për të përcaktuar kërkesën është pjesë e fazës së hulumtimit, kështu që duhet të shpenzohet.

Kostot në fazën e zhvillimit mund të kapitalizohen vetëm nëse plotësohen të gjashtë kriteret në SNK 38 me:

- Mundësinë teknike të përfundimit të pasurisë
- Synimin për ta përfunduar dhe përdorur/shitur atë
- Aftësinë për ta përdorur/shitur atë
- Si do të gjenerojë pasuria përfitime të mundshme ekonomike në të ardhmen
- Disponueshmërinë e burimeve
- Aftësinë për të matur kostot në mënyrë të besueshme

Nëse plotësohen të gjitha kriteret, €1 milion e mbetur (€1.2 milion- €200,000) mund të kapitalizohet si një pasuri të paprekshme dhe të amortizohet gjatë jetës së saj të dobishme prej 5 vitesh.

Kostoja e Dizajnit të një Emri të Ri të Markës (€100,000)

SNK 38 ndalon njohjen e markave të gjeneruara brenda kompanisë, titujve kryesorë, titujve të botimeve, listave të klientëve dhe artikujve të ngjashëm. Edhe nëse është e angazhuar një palë e tretë, nëse emri i markës gjenerohet brenda kompanisë, ai nuk mund të njihet si një pasuri e paprekshme. Kjo ndodh sepse shpenzime të tilla shihen si pjesë e zhvillimit të emrit të mirë dhe jo si një pasuri e paprekshme e identifikueshëm veçmas. €100,000 e shpenzuara për konsultim/dizajnim të një emri të ri marke duhet të njihen si shpenzime në momentin e ndodhjes së tyre.

b) Pasuria është toka, jo toka dhe fabrika së bashku. Vlera e drejtë duhet të pasqyrojë tokën si një pasuri të pavarur, bazuar në përdorimin e saj më të lartë dhe më të mirë nga pikëpamja e një pjesëmarrësi në treg.

Sipas SNRF 13, përdorimi më i lartë dhe më i mirë duhet të jetë:

- *Fizikisht i mundur*: A është zhvillimi fizikisht i realizueshëm? Po.
- *Ligjërish i lejueshëm*: Rizonimi është i nevojshëm, por i mundur, dhe kostot janë të njohura (€1 milion).
- *Financiarisht i realizueshëm*: Vlera duhet të tejkalojë kostot e zhvillimit dhe rizonimit.

Përdorimi	Detajet	Vlera
Përdorimi aktual- punishte për fabrikë	Tokë e përdorur për fabrikën	€10 milion
Tokë + Fabrika së bashku	Siç është, nuk ndahet lehtë	€20 milion
Tokë rezidenciale e Lirë (para-zhvillimit)	Para zhvillimit, jo e rizonuar	€15 milion (përfshijë rizonimin)
Vlera e mbetur e tokës	Pas kostove të zhvillimit (përfshijë rizonimin)	€25 milion
Vlera e tokës (minus marzhi normal i fitimit)	Pas zbritjes së marzhit të zhvilluesit	€17 milion
Kostot e ri-zonimit dhe ligjore	Për të mundësuar zhvillimin e banimit	(€ milion)
Kostot e demolimit	Për të liruar vendin	(€2 milion)

Përdorimi më i lartë dhe më i mirë:

- Vlera bruto e tokës (pas zhvillimit dhe marzhit): €17 milion
- Minus: kostot e ri-zonimit/ligjore: €1 milion
- Minus: kostot e demolimit: €2 milion
- Vlera Neto: €14 milion

Përdorimi më i lartë dhe më i mirë është për zhvillim banesor, pasi jep një vlerë të drejtë më të lartë (€14 milion) sesa përdorimi aktual (€10 milion).

Çështje të tjera kryesore

Klori sh.a mund të mos ketë qëllim ose aftësi për të prishur fabrikën. Por kjo nuk është relevante për vlerën e drejtë - vetëm supozimet e pjesëmarrësve në treg kanë rëndësi.

c) Sipas SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente*, Bakri sh.a duhet të vlerësojë nëse dëmi i mundshëm mjedisor shkakton:

- Një detyrim aktual (ligjor ose të terthortë),
- Një dalje të mundshme të burimeve ekonomike, dhe
- Një vlerësim të besueshëm të detyrimit.

SNK 37 përcakton një detyrim aktual si:

- Detyrim ligjor: nga një kontratë, legjislacion ose veprim tjetër i ligjit.
- Detyrim i terthortë: lind nga veprimet e një entiteti ku:

- U ka treguar palëve të tjera se do të pranojë përgjegjësi të caktuara, dhe
- Si rezultat, është krijuar një pritje e vlefshme.

Nuk përmendet ndonjë kërkesë ligjore që e detyron kompaninë të pastrojë dëmet mjedisore. Megjithatë, detyrimi i tërthortë mund të lindë nëse:

- Kompania ka një histori të mirë të adresimit të dëmeve të tilla,
- Ka bërë angazhime publike ose të brendshme për të mbrojtur mjedisin ose speciet lokale
- Ose ka pritje të komunitetit bazuar në sjelljen e kaluar. Nëse asnjë nga sa më sipër nuk ekziston dhe ende nuk ka ndodhur ndonjë rrjedhje aktuale, nuk ka asnjë detyrim aktual. Prandaj, nuk duhet të njihet asnjë provizion.

A është e mundshme një dalje burimesh?

Një dalje konsiderohet e mundshme kur ka më shumë gjasa sesa jo (domethënë >50%) që do të kërkohej një dalje burimesh. Inxhinierët e brendshëm kanë vënë re dobësi të pazbuluara që përfundimisht mund të çojnë në rrjedhje. Megjithatë, kjo sugjeron që ngjarja është e mundur, jo e mundshme. Nëse kompania nuk mund të arrijë në përfundimin se ka rrjedhje, ka më shumë gjasa sesa jo, nuk duhet të bëhet asnjë provizion, në vend të kësaj, kompania duhet të marrë në konsideratë shpalosjen e një detyrimi kontigjent.

A mund të vlerësohet shuma në mënyrë të besueshme?

Kostoja e rikthimit të pangolinëve është deklaruar si €1,750,000, e cila mund të shërbejë si një vlerësim i besueshëm i dëmit mjedisor. Pra, nëse ka një detyrim aktual dhe një dalje të mundshme, kjo shumë mund të formojë bazën e një provizionit.

Nëse nuk ka ndodhur asnjë rrjedhje dhe dëmi është vetëm një ngjarje e mundshme në të ardhmen:

- Nuk ka detyrim aktual.
- Nuk ka asnjë provizion për t'u njohur.
- Kompania duhet të shpalosë një detyrim kontigjent, duke deklaruar natyrën e rrjedhjes së mundshme dhe koston e vlerësuar (€1,750,000) nëse do të ndodhte.

d)

Data	Përshkrimi	Numri i aksioneve	Proporcioni kohor	Bonus	Mesatarja e ponderuar
01 janar 2024	s/fillim	6,000,000	x 3/12	x 2/3	1,000,000
01 prill 2025	Konsolidimi i aksioneve				
	(6,000,000/3 x 1)	<u>(2,000,000)</u>			
	(6,000,000 x 2/3)	4,000,000	x 6/12		2,000,000
01 tetot 2025	Emetuar me çmim te tregut	<u>600,000</u>			
	S/fund	4,600,000	x 3/12		<u>1,150,000</u>
					4,150,000

- Aksionet e ndara përfshihen nga data kur paratë janë të arkëtueshme (1 tetor 2025), SNK 33 paragrafi 21(a).
- Fitimi i thjeshtë për aksion = $(€478,000)/4,150,000 = (11.5)$ cent humbja për aksion.

Megjenëse aksionet preferenciale janë të riblershme (ripagueshme), ato kontabilizohen si një detyrim financiar sipas SNK 32 *Instrumentet Financiare: Paraqitja* dhe për këtë arsye pagesa e dividendit trajtohet si një kosto financiare, kështu që nuk kërkohet asnjë rregullim i mëtejshëm i fitimeve pasi dividendët përfshihen në kostot financiare.

5. Hidrogjeni sh.a ngriti në detyrë drejtorin e tyre të financave. Fitimi i kompanisë duket të jetë i mirë, megjithëse të ardhurat nga shitjet nuk janë rritur sipas pritjeve. Ju jeni emëruar për të shqyrtuar pasqyrat financiare të përgatitura nga drejtori para se ai të largohet dhe për të përgatitur një raport që do të përfshihet në Raportin Vjetor.

Pasqyrat financiare të Hidrogjeni sh.a për vitin aktual dhe të mëparshëm janë paraqitur më poshtë:

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor

	2025	2024
	€'m	€'m
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	965	846
Pasuritë financiare	55	70
Investimet në filiale	<u>120</u>	<u>185</u>
	1,140	1,101
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>		
Stoqet	155	130
Të arkëtueshmet tregtare	145	125
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<u>385</u>	<u>325</u>
	<u>685</u>	<u>580</u>
Total pasuritë	1,825	1,681
<i>Ekuiteti:</i>		
€1.50 Aksione të zakonshme	450	200
Rezerva e rivlerësimit	40	105
Rezerva e korigjimit të vlerës së drejtë	(30)	15
Fitimet e mbajtura	<u>905</u>	<u>716</u>
	1,365	1,036
<i>Detyrimet afatgjata:</i>		
15% Notë krediti	100	150
Tatimi i shtyrë	<u>30</u>	<u>45</u>
	130	195
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>		
Të pagueshmet tregtare	260	385
Tatimi aktual	<u>70</u>	<u>65</u>
	<u>330</u>	<u>450</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,825	1,681

Pasqyra e fitimit pse humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor

	2025	2024
	€'m	€'m
Të hyrat	1,550	1,350
Kosto e shitjes	<u>(700)</u>	<u>(670)</u>
Fitimi bruto	850	680
Të ardhurat tjera operative	30	-
Shpenzimet administrative	(160)	(38)
Kosto e shpërndarjes	(35)	(24)
Shpenzimet tjera operative	<u>(20)</u>	<u>(15)</u>
Fitimi operativ	655	603
Kosto financiare	(15)	(12)
Të ardhurat nga investimet	<u>25</u>	<u>15</u>
Fitimi para tatimit	675	606
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>(165)</u>	<u>(135)</u>
Fitimi i vitit	510	471
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:		
Rivlerësimi i investimeve në ekuitet	(30)	15
Rivlerësimi i pronës	<u>(65)</u>	<u>25</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	545	511

Informata shtesë

1. Jo-financiare:

Hidrogjeni sh.a ka përjetuar një qarkullim të lartë punonjësish dhe ata që janë ende në punë janë të demotivuar. Për më tepër, për shkak të faktorëve të ndryshëm ekonomikë, mendohet se jeta e dobishme ekonomike e pasurive jo-qarkulluese është në fakt dy herë më e gjatë se sa duhet të jetë.

2. Hidrogjeni sh.a investoi gjithashtu në 10,000,000 aksione të një kompanie të listuar në bursë në janar 2024 me një kosto prej €7.00 për aksion. Kostot e transaksionit që lidhen me investimin ishin €800,000 dhe u llogaritën saktë në atë vit. Çmimet e aksioneve të tregut u rritën në €8.50 më 31 dhjetor 2024 dhe ranë në €5.50 më 31 dhjetor 2025. Lëvizjet në vlerën kontabël të investimit janë paraqitur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Kërkohe:

Analizoni performancën financiare dhe pozitën financiare të Hidrogjeni sh.a-së. (20 pikë)

5.

	2025	2024
Marzha e fitimit bruto (%)		
FB / shitjet x 100		
850/1,550 x 100 =	54.8%	
680/1,350 x 100 =		50.3%
Marzha e fitimit operativ (%)		
FO / shitjet x 100		
665/1,550 x 100 =	42.9%	
603/1,350 x 100 =		44.7%
Kthimi në kapitalin e angazhuar (%)		
FPIT dhe te ardhurave nga investimet / (Ekuiteti + Borxhi) x 100		
Kapitali i angazhuar		
1,365 +100 = 1,465		
1,036 +150 = 1,186		
665/1,465 x 100 =	45.4%	
603/1,186 x 100 =		50.8%
Leva (%)		
Ekuiteti / (Ekuiteti + Borxhi) x 100		
Kapitali i angazhuar		
1,365 +100 = 1,465		
1,036 +150 = 1,186		
1,365/1,465 x 100 =	93.2%	
1,036/1,186 x 100 =		87.3%
Qarkullimi i pasurive		
Të hyrat nga shitjet / Kapitali i angazhuar		
1,550/1,465 =	1.06	
1,350/1,186 =		1.14

Shënim: verzione të tjera të llogaritjes së koeficientëve apo të koeficientëve të tjerë janë të pranueshëm

Koment:

Kompania mund të mburret me një marzh të lartë fitimi bruto dhe marzh fitimi operativ. Megjithatë, duket se ka një madhësi jashtëzakonisht të vogël të shpenzimeve sepse marzhi i fitimit operativ është vetëm 9 pp më i vogël se marzhi i fitimit bruto në vitin 2025 dhe 6 pp më i vogël se marzhi i fitimit bruto në vitin 2024. Ka shumë të ngjarë që kostot e zhvlerësimit të jenë nënvlerësuar shumë sepse jeta ekonomike e pasurive është dy herë më e madhe se sa duhet të jetë. Për më tepër, fakti që kompania përjeton qarkullim të lartë punonjësish sugjeron që punonjësve nuk u paguhen paga ekonomike, dhe kështu kostot administrative janë gjithashtu nënvlerësuar shumë.

Këto kosto ka të ngjarë të ulin marzhin e fitimit operativ me rreth 10 pp ose 15pp. Lëvizjet në vlerat e drejta të aksioneve janë klasifikuar gabimisht në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Megjithatë, nëse ato do të përfshiheshin në zonën e tyre të klasifikimit të duhur në fitim ose humbje të vitit, marzhi i fitimit operativ nuk do të ndikohej ende.

Përfundim: Nëse pagat do të rriteshin në shuma ekonomike, punonjësit do të motivoheshin edhe për të rritur të ardhurat nga shitjet. Kompania do të arrinte gjithashtu mbajtjen e punonjësve sepse do të kishte punonjës të lumtur. Llogaritja e zhvlerësimit duhet të rishikohet menjëherë në mënyrë që kostoja e vërtetë e përdorimit të pasurive jo-qarkulluese të mund të pasqyrohet në pasqyra. Kjo do t'i mundësonte kompanisë të përmbushte kërkesat e SNK 16 *Prona, fabrika dhe paisjet.*